



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**KUVENDI I KOMUNËS SË MALISHEVËS**

Kuvendi i Komunës

Nr.02/\_\_\_\_\_

Datë: 19.06.2024

Në bazë të nenit 12 paragrafi 2 shkronja (d), nenit 17, nenit 40 paragrafi 2 shkronja (h), të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, "Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës", nr.28/15 qeshor 2008", bazuar në nenin 9 paragrafi 3 shkronja (b), nenit 23 paragrafi 1 shkronja (a), të Statutit të Komunës së Malishevës nr.02/441 datë:14.09.2024, vendimit nr.02/225 datë: 05.06.2024, propozimit nr.01/682 datë:06.06.2024 të Këshillit Organizativ, Kuvendi i Komunës së Malishevës, në mbledhjen e pestë të rregullt e mbajtur me datë: 13.06.2024 merr këtë:

**VENDIM**

- 1.Miratohet vendimi për ndarjen e çmimit "Hamdi Berisha" për kontributin e dhënë në shkollën shqipe, z. Bajram Samadraxha (pas vdekjes) nga fshati Banjë Komuna e Malishevës.
- 2.Bazuar në pikën 1 të këtij vendimi, çmimi i ndahet nga Kuvendi i Komunës së Malishevës me datë:13.06.2024 dhe i njehti mbështetet në Statutin e Komunës së Malishevës.
3. Çmimi do të jepet publikisht më datë:14.06.2024 me rastin e shënimit të 25 vjetorit të Ditës së Çlirimit dhe të Dëshmorëve të Komunës së Malishevës.
- 4.Mjetet në shumë prej 200euro (dyqind euro) ndahen nga kategoria e subvencioneve-bloku kodues 10/625/16313/00000/0130, Drejtoria e Administratës së Përgjithshme dhe mjetet do të barten në llogarin bankare të djalit Bekim Samadraxha.
- 5.Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Kryetari i Komunës, përmes drejtorive komunale.
6. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Malishevës, ky vendim hynë në fuqi sipas nenit 81, të Ligjit nr.03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, si dhe në pajtim me nenin 8 dhe 9 të Rregullores (QRK) Nr.10/2019 për Shqyrtimin e Administrativ të Akteve të Komunave, e ndryshuar dhe e plotësuar, me Rregulloren (QRK) nr.06/2021, përkatësisht pas shpalljes në ueb-faqen e Komunës.

Vendimi ju dërgohet :  
MAPL-së  
Arkivit të Komunës  
Drejtorive të KK-së

Kryesuesi i Kuvendit  
Argjend Thaçi

